



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Ministarstvo Kulture, Omaladine i Sporta -
Ministry of Culture, Youth & Sports*

**THIRRJE PUBLIKE PËR PUNË PRAKTIKE PËR STUDENTE E NGA FAKULTETI
FILOZOFIK (drejtimet Antropologji Kulturore dhe Arkeologji)**

Qëllimi

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit me Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetin Filozofik, hapë thirrje publike për punë praktike me pagesë në shumën prej 250€ Bruto, për gjashtë (6) muaj në institucionet e Trashëgimisë Kulturore në kuadër të MKRS-së. Përkatësisht, praktika në punë do të ofrohet në MKRS/DTK, Muzeun Kombëtar të Kosovës, Institutin Arkeologjik të Kosovës, Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, QRTK Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren Ferizaj, Gjilan Muzeu i Burgut të Prishtinës.

Kriteret e përgjithshme për aplikim

Të drejtë aplikimi kanë të rinjtë:

1.Studentët në vitin e fundit të studimeve Bachelor apo student në studime Master (drejtimet Antropologji Kulturore dhe Arkeologji); dhe

Aplikacioni duhet të përmbajë:

- Titulli në e-mail (subject line) të specifikojë institucionin në të cilin aplikohet për praktikë në punë;
- Bashkëngjitur vërtetimin që jeni duke i vijuar studimet
- Bashkëngjitur transkriptin e notave të vitit paraprak
- Bashkëngjitur një referencë nga një profesor (e nënshkruar)
- Bashkëngjitur kopjen e letërnjoftimit të aplikueses/it
- Bashkëngjitur konfirmimin bankar

Aplikacionet duhet të dërgohen përmes postës elektronike: praktikpune.mkrs@rks-gov.net

Afati i fundit për aplikim është 30 Maj 2024.

Procesi i përzgjedhjes:

Aplikimet do të shqyrtohen nga Komisioni në MKRS, të cilët do të publikojnë një listë finale të kualifikuarve për punë praktike. Nëse vlerësohet e nevojshme, Komisionet mund të zhvillojnë intervista me kandidatët për të përzgjedhur studentët e kualifikuar për fillimin e punës praktike, bazuar në kriteret e specifikuar të aprovuara me vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr. 2448/20 i datës 10/05/2024.

Numri maksimal i studentëve të pranuar për punë praktike do të jetë 13 student. Në rast që numri i studentëve që i përmbushin kriteret është më i lartë se 13, atëherë komisioni do t'i përzgjedhë studentët me notën më të lartë mesatare.